

Ti konsiderohesh fëmijë nëse je nën moshën 18 vjeç



FËMIJË TË NDARË NË MB

# CILAT JANË TË DREJTAT E TUA?



DISA  
KËSHILLA  
DHE KONTAKTE  
TË DOBISHME PËR  
TË TË NDIHMUAR



Bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian



# TI KE TË DREJTË TË FLASËSH

MIRË TË DIHET

Ti ke të drejtë për **përkthyes falas** nëse nuk e ke anglishten gjuhë amtare (por ndonjëherë kjo do të bëhet përmes telefonit). **Përpiqu të sigurohesh se përkthyesi ta kupton dialektin që në fillim.**

Profesionistët (policët, avokatët, kujdestarët/ përfaqësuesit, punonjësit socialë, punonjësit e bimirësive, gjykatësit, mjekët, etj.) janë njerëz të cilëve mund t'u **besosh**

**MOS  
NGURRO TË  
PYESËSH PËR TË  
DREJTAT E TUA DHE  
TË SFIDOSH GJËRAT  
ME TË CILAT NUK  
PAJTOHESH!**

# PA PATUR FRIKË



**LINJA E FËMIJËVE**  
Informacion dhe këshilla të përgjithshme për fëmijë

**0800 1111**  
falas, 24 orë dhe konfidenciale


ose vizito  
<http://childline.org.uk/>



**NDIHMJA TELEFONIKE PËR SKLLAVERI MODERNE**

Për të raportuar nëse mendon se të kanë shfrytëzuar

**0800 0121 700** falas,  
24 orë dhe konfidenciale



**NJERËZ TË HUMBUR**

Për këshilla dhe mbështetje nëse humb apo largohesh fshehurazi

Telefono ose çò sms  
**116 000**  
falas, 24 orë dhe konfidenciale

Për të raportuar një krim,  
ose nëse ke frikë për  
sigurinë tënde apo të  
dikujt tjetër, telefonoji  
policisë:

**999**





## Ç'MUND TË BËJË POLICIA PËR TY?

MBI POLICINË

Policia është aty për të të ndihmuar të jesh i sigurt. Për shembull, duhet të flasësh me policinë nëse dikush të kërcënon, lëndon ose detyron të bësh diçka që nuk do apo që është e dëmshme për ty.

Ti NUK ke pse ndëshkohesh për diçka që ke qenë i detyruar të bësh, edhe nëse është e gabuar apo kundra ligjit. Policia mund të të bëjë shumë pyetje, por ti përpiqu të jesh i sigurt. Mund të kërkosh për një të rritur apo përfaqësues të besuar që të të asistojë gjatë intervistës.

POLICIA  
999

MBI PUNËN SOCIALE NË NJËSITË VENDORE

➤ Në Mbretërinë e Bashkuar, nëse vërehet se je në rrezik dëmtimi ose ndahesh nga familja, do të të caktohet një punonjës social.

➤ Roli i tij apo saj do të jetë për të të dhënë ndihmë, strehim dhe mbështetje. Prandaj duhet të tregohesh i sigurt, se punonjësi social do ta ketë më të lehtë të të ndihmojë dhe sigurojë kujdesin që të duhet kur e njuh historinë dhe pritshmëritë e tua.



# Ç'ËSHTË TRAFIKIMI NJERËZOR?

Ti ose një nga shokët e tu mund të jeni viktimë e trafikimit pa e kuptuar.

A ke qenë në një situatë ku të është dashur të:

- bësh seks apo kryesh vepra seksuale?
- punosh (për shembull, në shtëpinë e dikujt duke kryer punë shtëpiake apo kujdesur për fëmijë, në fabrikë apo në restorant)?
- lypësh, vjedhësh ose kryesh krime?
- rritësh, mbash ose shesësh drogë?
- heqësh organet e tua për t'i shitur?
- shlyesh një 'borxh' duke punuar apo dhënë ndonjë shërbim tjetër? A ke qenë ti/familja jote nën kërcënim?

Nëse i përgjigjesh "po" njërës prej këtyre pyetjeve, ti ose shoku yt mund të jeni viktima trafikimi.

Trafikimi njerëzor është krim serioz dhe abuzim i të drejtave të tua.

Bisedo me një profesionist të cilit i beson nëse je i shqetësuar që të ndihmojë me ndaljen e abuzimit dhe mbrojtjen e të rinjve të tjerë.

- Punonjësi social do të përpilojë një plan kujdesi që duhet diskutuar me ty. Varur nga ku ndodhesh në MB, mund të të caktohet edhe një kujdestar ose përfaqësues i pavarur që do të ndihmojë me shpjegimin e gjithçkaje dhe me mbrojtjen e të drejtave të tua.

- Do të të jepet strehim, por ky ndryshon në rastin e secilit person nën moshë. Sigurohu që t'i diskutosh parapëlqimet e tua me punonjësin social.





Mund t'i kërkosh punonjësit social, kujdestarit/ përfaqësuesit ose punonjësit të bamirësisë të të ndihmojë të gjesh një avokat.

## AVOKATËT

Në MB, në shumë situata ti ke të drejtën për avokat falas, përfshi:

- Nëse kërkon azil
- Nëse ka arsye të dyshohet se të kanë trafikuar
- Nëse të kontestohet mosha
- Nëse akuzohesh për një krim

Nëse je nga një vend tjetër, mund të të duhet leje nga Ministria e Brendshme për të qëndruar këtu.

Kjo mund të thotë se duhet të aplikosh për azil, mbrojtje humanitare ose leje qëndrimi për të qëndruar ligjërisht në MB: Do të të duhet të flasësh me një punonjës social dhe një avokat imigracioni për mundësitë që ke.

Por ki parasysh se nuk të duhen dokumente zyrtare ose status imigrimi për të përfituar nga sistemi i mbrojtjes së fëmijëve, që u sigurohet të gjithë fëmijëve në nevojë ose të ndarë nga familja.

Mund të aplikosh për azil me ndihmën e punonjësit tënd social dhe një avokati për imigracion, pavarësisht nga mosha që ke. Shpesh ky është një proces i gjatë dhe i ndërlikuar, prandaj mos ki frikë të bësh pyetje dhe të sigurohesh se i kupton të drejtat e tua.



Nuk lejohet që fëmijët të mbahen në qendra izolimi për qëllime imigracioni në MB

# VLERËSIMI I MOSHËS

Duhet të flasësh me avokatin, kujdestarin ose përfaqësuesin që të të ndihmojnë me këtë.

Nëse ti nuk ke dokumente që vërtetojnë moshën tënde, ose ka mëdyshje mbi dokumentet e tua, mund të të bëhet një vlerësim për moshën.



## SHËNDETËSIA

Ke të drejtën për kujdes mjekësor FALAS dhe mund të marrësh trajtim falas në spitale. Pyet punonjësin social se ku mund ta përdorësh këtë shërbim.

## ARSIMI

Ke të drejtën të kesh arsim FALAS dhe punonjësi social duhet të ndihmojë me sigurimin e realizimit të kësaj.

MBI ASISTENCËN E PËRGJITHSHME



### **Çfarë janë bamirësitë?**

- Këto janë organizata të pavarura nga qeveria që janë hartuar për të ndihmuar fëmijët. Mund t'i kontaktosh vetë direkt ose t'i kërkosh një profesionisti për ndihmë me gjetjen e një bamirësie të përshtatshme për asistencë.

### **Ç'mund të bëjnë ato për ty?**

- Ato mund të të sigurojnë asistencë dhe mbështetje shtesë, si grupe sociale, përfaqësim, mësimë anglishteje, etj.


### **Pse duhet të kesh besim te to?**

- Ato do të punojnë për të mirën tënde dhe do të të ndihmojnë të kuptosh të drejtat e tua.





# KONTAKTE TË DOBISHME BAMIRËSISH /OJQ-SH (JO-URGJENTE)



**BARNARDO'S**  
**0207 700 2253**  
(9.00-17.00)

**ECPAT UK**  
**0207 607 2136**  
(9.00-17.00)  
[www.ecpat.org.uk](http://www.ecpat.org.uk)

**CORAM**  
**QENDËR LIGJORE**  
**PËR FËMIJË**  
**0207 636 8505**  
(e martë - e enjte 10.00-16.00)



**SHOQATA E FËMIJËVE**  
**0208 221 8200**  
(9.00-17.00)

**QENDRA KËSHILLIMORE NSPCC PËR TRAFIKIM FËMIJËSH**  
**020 3772 9513**





INFO-KONTAKTE







Ky botim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përbajta e këtij botimi është përgjegjësi ekskluzive e ECPAT Francë dhe partnerëve të tij në projektin ReACT: ECPAT Belgjikë, ECPAT Gjermani, ECPAT Holandë dhe ECPAT MB dhe nuk mund të merret në asnjë mënyrë si pasqyrim i pikëpamjeve të Bashkimit Evropian.

